



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 28 shtator 2022, në mbledhjen e VII-të (shtatë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10;20.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Naim Çunaku, Arnisa Sylejmani, Adelinë Stublla, Florent Hasani, Sebastina Vokri, Bashkim Sylja, Mrika Thaçi dhe Qëndrim Softolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin edhe; Fatlum Osmani U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, Bahri Selimi U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, dhe Vigan Salihu U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit duke ua rikujtuar thirrjen dhe materialin e kësaj mbledhje i cili është dërguar paksa me mund sepse ka qeshë shumë voluminoz. Konstatoi kuorumin dhe ftoj nëse ka të interesuar për të marrë fjalën sa i përket pikave të rendit të ditës, nëse jo atëherë e hedh në votim rendin e ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës të dërguar.

Pas votimit, njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës dërguar anëtarëve të KPF-së, respektivisht anëtarëve të Kuvendit të Komunës.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28.07.2022

z.Naim Çunaku, theksoi, kam hasë në një fjalë ku unë e kam thënë profesionistë, kurse është shkruar profesionalista, andaj do të ishte mirë të rregullohej kjo edhe pse nuk paraqet ndonjë problem në përmbajtje.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 8 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent miratohet procesverbali nga mbledhja e KPF-së e mbajtur më 28.07.2022, përfshirë edhe korrigjimin sipas asaj që e ceku parafolësi, dhe atë; që në faqen 3 të procesverbalit, në diskutimin e z.Naim Çunakut ku në rreshtin e tretë, fjala “profesionistëve” të zëvendësohet me;profesionistëve.....

2. Propozim Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025

z.Fatlum Osmani, U.D. drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave-DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth projekt buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025, për të cilin theksoi se në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të Komunës është planifikuar miratimi.

Buxheti dhe pozicionet buxhetore që miratohen normal që pastaj kthehen në ligj në kuadër të Ligjit për buxhetin e Republikës së Kosovës, ndërsa planifikimet për 2024-2025 janë projeksione buxhetore miratohen në kuadër të planeve strategjike të Komunës së Podujevës e të cilat pastaj mund edhe të ndryshohen sepse nuk hyjnë në kuadër të Ligjit që e ceka.

Për këtë buxhet i kemi mbajtur edhe diskutimet publike dhe kryesisht janë projekte të cilat janë miratuar me Kornizën Afatmesme Buxhetore

Materialin e keni marrë me kohë, mirëpo janë paraqitur disa ndryshime që duhet të bëhen e të cilat kryesisht janë riemërtime dhe disa ndryshime krejt teknike për shkak të disa rekomandimeve që kanë ardhur nga Ministria e Financave më datë 20.09.2022, pasi ne e kemi dërguar propozim buxhetin në Kuvend, kështu që nesër do t'i paraqes në mënyrë të shkoqitur edhe ndryshimet për të cilat e potencova se janë krejt teknike dhe nuk kanë asgjë përmbajtjesore në raport me materialin e buxhetit që e kemi para vetës.

z.Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë se kemi të bëjmë me një prej dokumenteve më të rëndësishme që brenda një viti kalendarik kalon përmes anëtarëve të Kuvendit, gjegjësisht edhe kërkon miratimin nga Kuvendi, pa dyshim se është projekt buxheti i Komunës si dokument i cili përcakton kahjet zhvillimore dhe orientimin e parasë publike të taksapaguesve të komunës, dhe për të ardhur deri tek një projektbuxhet i cili ngërthen në vete konturat e një zhvillimi të qëndrueshëm si tek kapitalet, si tek subvencionet, si tek kategoria e kontraktiveve dhe shpenzimeve komunale, pagave dhe mëditjeve, sigurisht se me vetë faktin se për një përgatitje të një projektbuxheti parashihen që të jenë të inkuadruar strukturat dhe autoritetet e caktuara nga 30 prilli deri më 30 shtator kur është edhe afati i fundit për miratim dhe të bëhet dokument final, vetë kjo kohë që është përcaktuar kaq gjatë, që duhet të jenë të involvuar të gjithë akterët që në një formë kategoritë e caktuara i prek një buxhet i mirëfilltë.

Pa dashur të hyjmë në detaje sepse edhe ashtu drejtori parafolës e ceku se specifikat dhe çështjet tjera do t'i bëjmë nesër, edhe unë jam i mendimit se nesër në mbledhjen e Kuvendit do t'i paraqesim specifikisht të gjitha, mirëpo diçka që e kam vërejtur e që e kam potencuar edhe më përpara në mbledhjet e KPF-së, pa dashur që të tregoj diçka të re sepse kompetencat e KPF-së i ka përcaktuar vetë Ligji për vetëqeverisje lokale dhe është një prej shtyllave kryesore në veçanti ku kemi të bëjmë me projektbuxhetin dhe me politikën fiskale si dhe me të gjitha politikën e Kuvendit, por në veçanti me buxhetin e Komunës, do të doja të parashitja në rend të parë pyetje vetit por edhe të gjithëve këtu, a kemi qenë ne si KPF në rolin tonë që na e përcakton Ligji, në hartimin e buxhetit.

I nderuar Kryesues i Kuvendit, pa dashur të hyjë specifikisht, KPF asnjë dëgjim, KPF e trajton barabartë e trajton si gjithë të tjerët një dokument kaq të rëndësishëm për të cilin folëm.

Disa që kemi përvojë më të madhe në Kuvend, madje edhe në një punëtori që kemi marrë pjesë gjithë anëtarët e KPF-së duke përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit dhe Komitetit, takstativisht është diskutuar rruga dhe përgjegjësitë që ka dhe që duhet t'i merr KPF, a jemi aty, jemi dëshmitar se jo nuk jemi, andaj do të doja pa qëllime politike sepse buxheti nuk është politik edhe pse është e vërtetë se orienton disa programe ku parashihen të nevojshme e që edhe mund të kenë ngjyrimë politike, por buxheti para së gjithash është taksë dhe buxhet i qytetarëve të Komunës dhe ne jemi atë të thirrurit që të japim kontributin dhe orientimin tonë ashtu siç duhet.

Ky dokument është shumë i përgjithësuar dhe nuk ka specifika, madje po ta bëjmë një digresion dhe të hyjmë në një projektbuxhet të para disa viteve në atë kohë kur i kemi pasë rolet e ndryshme në që sot jemi këtu të njëjtë por me pozicione të ndryshme si dhe po të hyjmë në ueb faqe të Komunës dhe t'i shohim ato diskutime që poenta kryesore e gjitha subjekteve opozitare ka qenë, përse projekte të përgjithësuara, Komuna jonë çdo rrugë e ka të emërtuar, përse asnjë rrugë nuk është e përcaktuar se ku do të shkojnë ato projekte, pastaj ato ndarje a janë vetëm sa për t'i kënaqë... me shuma prej 20,000.00€ - 30,000.00€ e që çfarë mund të ndërtohet me ato shuma, dhe kur krejt këto i merë për bazë, pavarësisht se jam në dijeni për rëndësinë e këtij dokumenti, e di se nuk e kemi ndjekë rrugën e duhur për ta ndërtuar një projektbuxhet të qëndrueshëm dhe karshi nevojave të qytetarëve.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, në Grupi i LVV-së i rekomandojmë Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës.

z. Bashkim Sylja, theksoi, edhe në Grupi i PDK-ës i rekomandojmë Kuvendit për diskutim dhe miratim të këtij propozim vendimi në seancën e ardhshme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së sa ishin prezent, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim të propozim vendimit për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2023 dhe parashikimet buxhetore për 2024/2025, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

3. Propozim Vendimi për ri-alokimin e investimeve kapitale të Komunës për vitin 2022

z. Fatlum Osmani, U.D. drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi ndër të tjera theksoi, fillimisht falënderoj për rekomandimin për diskutim në seancën e Kuvendit projektbuxhetin e Komunës për vitin 2023 dhe planifikimet buxhetore për vitet 2024-2025 dhe besoj se do të kemi çfarë të diskutojmë sepse është buxheti më i madh në histori të Komunës dhe po besojmë që është më i miri që ndonjëherë e ka pasë Komuna e Podujevës.

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, bëhet fjalë për ndërtimin e rrugës nga magjistranja Podujevë-Prishtinë deri te rr."Vëllezërit Frashëri" dhe në mënyrë që ta kemi më të qartë fjala është për rrugën që vazhdon nga Xhamia deri tek magjistranja, për shkak se është një projekt paksa më specifik dhe që ka të bëjë edhe me shpronësimin e pronave dhe që kalon përmes Ministrisë së Financave me elaborat të shpronësimeve si dhe për shkak të një problemi që ka pasë Komuna e Podujevës lidhur me kontratën për hartim të projektit e që ka ankesa në OSHP e që ka një vonesë për realizimin e këtij projekti dhe për këtë arsye mjetet që janë të planifikuara për këtë projekt janë propozuar që të rialokohen në ndërtimin e rr."Skënderbeu" si dhe për asfaltimin dhe zgjerimin e rrugëve dhe rrugicave në qytet.

Asfaltimi i rr."Skënderbeu" jeni në dijeni se ka një kontratë sipas të cilës dinamika e realizimit të këtij projekti ka qenë 200 ditë, dhe bëhet fjalë për një kontratë dy vjeçare, andaj meqë ka një dinamikë të mirë mundësia është që ky projekt të kryhet në këtë vit, andaj edhe është propozuar që mjetet nga projekti i cekur që faktikisht nuk po mund të realizohet të barten në projektin që është i mundshëm të realizohet në mënyrë që edhe të realizohet një projekt që është shumë madhor por edhe të mos kemi suficit të buxhetit. Pra kjo është arsyeja që e kemi propozuar një propozim vendim të tillë për rialokimin e investimeve kapitale.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që ta kalojmë pa asnjë diskutim më duket paksa jo mirë, andaj edhe për atë e kërkova fjalën, jo që jam kush e di sa i interesuar të diskutoj për këtë gjë.

Më bëri përshtypje pika 2 e rendit të ditës, e që drejtori parafolës e paraqiti duke i'u referuar fillimisht pikës 1 për të cilën bëri një konstatim e që për drejtorin mund të jetë i qëndrueshëm që ky buxhet është më miri, mirëpo mua më jep të drejt ti tregoj drejtorit se për mendimin tim është një buxhet i hartuar ndoshta më u mangëti që kam parë. Nuk shohin të gjithë njerëzit njëjtë, shikimin e kanë për t'u orientuar në kohë dhe hapësirë e që nuk orientohen të gjithë njëjtë, kështu që është në rrugën e çdo njerit të shohë atë çka dëshiron, andaj unë nuk e kundërshtova drejtorin që ai sheh diçka të mirë, andaj në të njëjtën kohë kërkojë nga ai që të ma respektoj edhe mendimin tim.

Sa im përket propozim vendimit për rialokim nga programi për investime kapitale të një projektbuxheti i cili kur është miratuar është paraqitur si nevojë që do të ketë impakt dhe rëndësi të veçantë për realizmin e atij projekti për të lehtësuar qarkullimin ndërtimi i asaj rruge nga e cila sot ka propozim t'i rialokojmë ato mjete. E kam bindjen që rialokimi sigurisht drejtori e dinë sepse është në detyrën e tij dhe nuk kam dyshim se e ka konsultuar nenin 30 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, dhe sigurisht se është në dijeni se kohë do të merr një rialokim i tillë në shumë rreth 75,000.00€ e që sigurisht se vlera e tij tejkalon edhe 30%-shin por edhe 25%-shin, e që dihet kompetencë e kujt është rialokimi sipas përqindjes, sa është në kompetencë të Qeverisë, sa të Kuvendit, e që kur tejkalohej rialokimi mbi 25% është kompetencë e vetëm Kuvendit të Kosovës, dhe po besoj se kështu është konsultuar, dhe nëse kështu parashihet që ne t'i kalojmë këto procedura përmes Kuvendit të Kosovës e që i gjithë interesi është që të mos mbetet buxhet i pashpenzuar në fund të vitit, shumë pajtojë që të mos ketë suficid sepse këto janë nevoja të qytetarëve, mirëpo rrugën që do ta ndjekim dyshoj buxheti për të cilin po bëjmë rialokim do të jetë i pashpenzuar.

z.Bashkim Sylja, theksoi, edhe kur kemi qenë në opozitë zakonisht rialokimet i kemi votuar për qëllimin më të mirë për të mos mbetur suficid dhe për të mos u kthyer ato mjete në Qeveri.

Sa i përket rrugës përkatëse që ka qenë e planifikuar, unë edhe kur është miratuar në vitin e kaluar kam qenë goxha skeptik për atë rrugë duke pas parasysh edhe projektet e mëdha në të kaluarën, mirëpo një pjesë e këtyre mjeteve ne po jemi në dijeni se po rialokohen për rr."Skënderbeu", por shuma prej 172,000.00€ të planifikuara për rrugë në qytet do të duhej të na jepen informata më shumë nesër në Kuvend sepse nuk po bëhet fjalë këtu për projekte të vitit të ardhshëm por për këtë vit. Do të thotë se dëshirojmë informacione më shumë rreth ndarjes së shumës 172,000.00€ për rrugë në qytet, përndryshe ne jemi Për, rialokimin e mjeteve sepse është në interes të Komunës tonë që të mos ketë suficid buxhetor.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të ljmëruar për të marr fjalën, e hedh në votim këtë propozim vendim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit për ri-alokimin e investimeve kapitale të Komunës për vitin 2022, sipas materialit të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

4. Propozim Rregullorja për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës - Raporti nga diskutimet publike

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, jemi në dijeni se kemi pasë një rregullore për orarin e punës së bizneseve dhe për këtë kemi pas edhe ankesa prej qytetarëve, përkatësisht ka pasë ankesa që të lejohet puna edhe ditëve të diela duke e krahasuar këtë çështje me Komunat që jemi fqinjë sidomos me Komunën e Prishtinës ku bizneset punojnë edhe të dielave duke paraqitur ankesat se nuk po punojmë dhe po kanë humbje bizneset.

Mua personalisht më kanë ardhur disa grupe të bizneseve me nënshkrime ku rreth 87 nënshkrime të një grupi të biznesmenëve, si dhe kam edhe tri të tjera nga bizneset (Egzonita, Univertrade dhe Agnesa), kështu që besoj se drejtori i Drejtorisë përkatëse ka punuar në këtë aspekt dhe madje është ngritur edhe një komision i veçantë në Kuvend për këtë çështje, andaj i'a kalojmë fjalën.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik-DPZHE, e paraqiti fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, sa i përket kësaj pike ë rendit të ditës është diskutuar bukur gjatë edhe këtu në Kuvend ku edhe është formuar grupi punues siç jeni në dijeni ku secili subjekt politikë ka pasë përfaqësuesin e vet në atë grup punues. Kemi mbajte dy diskutime/takime me grupin punues dhe si rezultat i atyre takimeve këtë draft Rregullore e kemi vë edhe në diskutim publik ku kohëzgjatja e tij ka qenë deri më datën 15 të këtij muaji, ndërsa për këtë peticion të sjellë tani është me vonës tani rreth 10 ditë pas përfundimit të diskutimit publik e që në bazë të rregullave ligjore merren parasysh vetëm brenda afatit të konsultimeve publike dhe nuk mundemi të pranojmë dokument tjetër jashtë afatit.

Propozoj që kjo të diskutohet dhe e njëjta të rekomandohet si pikë e rendit të ditës në mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet nesër.

z.Florent Hasani, theksoi, ne Grupi i LVV-së e mbështesim si pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e radhës.

z.Naim Çunaku, theksoi, rreth draft Rregullores për rregullimin orarin e punës të operatorëve ekonomik që veprojnë në Komunën e Podujevës e vërteta që ka ndodh me këtë Rregullore, lirshëm mund të them se më shumë ka ç'rregulluar se sa që ka rregulluar qysh prej ditës që është votuar në këtë Kuvend nga një përbërje tjetër e Kuvendit që ka qenë e që për habinë time në atë kohë është votuar unanimisht prej të gjitha Grupeve politike, përjashtoj një anëtar të Kuvendit që nuk e ka votuar e që është edhe sot anëtar i këtij Kuvendi. E mira e Rregulloreve është që ato hartohen dhe miratohen për të rregulluar një fushë të caktuar e në këtë rast të lehtësimit të operimit të tyre, por tek ne si duket e ka vështirësuar operimin dhe kjo vazhdimësia e kësaj ku qe 1 vit e gjysmë të merret dhe të mos bëhet një rregullore e cila do të jetë si zgjidhje për operatorët që operojnë në Komunën e Podujevës, vërtetë është shqetësuese.

Sa i përket këtij drafti dëshiroj të jap diçka konkrete e që nesër në Kuvend do ta bëjë edhe si propozim është se nuk do të doja apo mendoj se nuk është kompatible me Ligjet në fuqi dhe diçka që nuk është në përputhshmëri me Ligjet në fuqi e dim se mund të kthehet, dhe që as për vesh nuk tingëllon mirë, konkretisht bëhet fjalë tek predispozitat në përkufizime e që po e lexoj, thuhet, *shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin si vijon;* (dhe ajo që unë e kontestoj është), *festat zyrtare (ditë jo pune) nënkupton Vitin e ri, 17 shkurti, Fiter Bajrami, Dita e Kurban Bajramit,* e që mendoj se duhet të përmirësohet ose të paktën në këtë formë mendoj se nuk është në rregull sepse me vetë faktin kur i referohesh Ligjit për festat zyrtare dhe përmend festat zyrtare, çfarë ke nevojë të shkoqitësh se cilat janë festat zyrtare, apo nëse ke filluar të shkoqitësh cilat janë festat zyrtare të paktën duhet t'i referohesh Ligjit se si përcaktohen me Ligj festat zyrtare sepse në atë Ligj nuk ka term Fiter Bajram e as Kurban Bajram, por janë Bajrami i madh dhe Bajrami i vogël, por me vet faktin që nëse ne hyjmë dhe i cilësojmë vetëm festat tona, atëherë me automatizëm janë edhe disa festa tjera që janë festa zyrtare dhe

nuk punohet as për ato, andaj këtu në këtë çështje mund të ketë dy kuptimësi se në festat tjera zyrtare mund të punohet, përveç këtyre që janë përmendur, shembull kur janë kërkshëndellat mund të punohet, ndërsa në këto dy për Bajram jo. Pra ka mjaftuar të ceken vetëm festat zyrtare, dhe kush do që ka festë zyrtare, festa është e barabartë, si ajo e 17 Shkurtit, si ajo e ditës së Bajramit, si e Vitit të ri, sepse ashtu është e kualifikuar me Ligj.

Çështje tjetër është se nuk më ra të lexoj, disa operatorëve ekonomik nuk i'u është caktuar detyrim dita kur ata duhet të pushojnë, kurse shumë të tjerëve i'u është lënë në ingerencë të tyre, dhe tani po i marrë dy shembuj, t'jua caktosh floktarëve pushim ditën e martë, me automatizëm nëse ditën e martë nuk punojnë fizeret, nuk mund të punojnë as restorantet sepse janë goxha të ndërlidhura sepse dikush kur shkon në ndonjë dasëm apo aheng në ndonjë restorant, fillimisht shkon tek frizeret, prandaj nuk e di përse është dashtë të përmendet cila ditë të jetë pushim kur dihet se bizneset e mëdha e kanë lirinë e veprimit.

Për të mos e zgjatur më shumë, jam i mendimit se Komuna e Podujevës nuk mund të jetë ndaras nga Komunitet tjera, Ligjet në fuqi siç është ai për tregtinë e lirë ai për konkurrencën duhet të vlejë edhe për Komunën e Podujevës, e që e kam pritur se kjo rregullore do të jetë me më pak defekte dhe do të jetë e pëlqyer ashtu edhe siç e kemi mundësinë ligjore të veprojmë. Nuk kam qenë ithëtar i asaj që ka qenë përpara, unë jetoj në pjesën jugore të Komunës e që ditën e diel kam mundur lirshëm të furnizohem në fshatin Lupç por nuk kam mundur në Lupçin që është me territor të Komunës së Podujevës, por vetëm në anën tjetër të rrugës kam mundur sepse është me territor të Komunës së Prishtinës, andaj e them se kemi krijuar disbalancë apo më shumë ç'rregullim, prandaj në formën se si është tani ky draft nuk mund ta merr përkrahjen time, mirëpo për ta diskutuar në mbledhjen e Kuvendit po pa patjetër.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, theksoi, mendoj se shqetësimet e parafolësit janë me vend sa i përket termeve për festën e Bajramit të madh dhe Bajramit të vogël. Këto përmirësime do të bëhet dhe në rend të ditës do të sjellën me përmirësime, ndërsa sa i përket floktarëve ne draftin e kemi vë në diskutim publik dhe nuk ka pasë interesim prej floktarëve të bëhen ndryshime rreth orarit të punës dhe të përfshihen në Rregullore gjithë të cilën ndoshta keni mund ta vëreni edhe në raportin dhe procesverbalin nga diskutimet publike, kështu që ne jemi bazuar në diskutimet publike dhe e kemi sjellë si draft, mirëpo nëse e vlerësoni si kërkesë të duhur mundet të përmirësohet edhe kjo, dhe ditën e nesërme në seancën e kuvendit do të sjellët me ndryshime.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor, me qëllimin më të mirë bizneset që kanë qarkullim të pakrahasueshëm me ato ekonomi familjare (sepse zakonisht floktaret, berberët janë ekonomi familjare) dhe përderisa këtyre i'u jep përkufizime, pavarësisht interesit të tyre, asgjë nuk i dëmton nëse do t'jua heqësh përkufizimin edhe atyre, dhe krejt kjo ka mund të mbulohet me një fjali që çdo operator ekonomik ditën që ai e sheh të nevojshme ta shpall në ndonjë vend të caktuar për palët si ditë pushimi, dhe kaq do të përfundonte kjo, pa hyrë dhe t'jua caktosh këto kufizime, dhe këtë më së mirë si kontribut timin e jo si kundërshti.

Edhe një çështje që dua ta them është se procedura e diskutimit publik është bërë pa vendim të Kuvendit, nuk ka dhatë të ndodh ashtu, por tani ka ndodh dhe kaq.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa për plotësim të diskutimeve ju njoftoj se unë kam takuar njëherë rreth 20 përfaqësues të bizneseve dhe aty ka qenë edhe një përfaqësuese e floktareve e cila në fakt nuk ka kërkuar ditë të lirë por na ka treguar se floktaret kanë marrëveshje që ditën e martë nuk punojnë, dhe këtë e ka thënë në zyrën time, pra ka thënë se ne jemi dakorduar që ditën e martë nuk punojnë, mirëpo tani se si është sjellë tek Drejtoria nuk e di, a janë përfshirë edhe floktarët për meshkuj apo si është rregulluar kjo nuk e di, pra kjo kishte qenë e rregulluar kështu edhe me Rregulloren aktuale.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e di sa u kuptova i nderuar Kryesues, kush do që ka ardhur dhe kush do që vie, ne jemi hyrë dhe kemi ndërhyrë në Rregullore se kë ta lejojmë të punojmë e kë jo. Floktarët që i ceka dhe cilido tjetër, nëse me Rregullore i është lënë dikujt tjetër në ingerencë se çfarë dëshiron të bëjë vetë ai, atëherë edhe floktarëve shembull duhet t'iu lejohet të bëjnë çfarë të dëshirojnë vet ata, nëse ata nuk kanë interes të punojnë ditëve të martë, ata shumë publikisht e vendosin tabelën ku e cekin se nuk punojnë ditëve të marte, por nëse ne i'a përkufizojmë me Rregullore se nuk ka të drejtë të punoj pastaj në rast se ndonjëherë ndokush gjendet duke punuar kemi të drejtë ta sanksionojmë, pra do të thotë se kemi bërë pabarazi. Jo që po dëshiroj unë t'jua ndryshoj vullnetin floktarëve, por vetë sa për tu sqaruar.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra unë vetëm deshta ta them se Floktaret kishin traditë qysh moti që ditëve të martë nuk kanë punuar, prandaj tani neve na mbetet vetëm se si do ta inkorporojmë në rregullore, kjo është me rëndësi të rregullohet që në qoftë se ndokush dëshiron të punoj atë edhe mund ta bëjë, e që do të rregullohej edhe çështja sanksionimit pastaj.

z.Bashkim Sylja, theksoi, dita e martë për floktarët ashtu siç e di unë dhe siç kam informacione është se në bazë të diskutimit publik për rregulloren aktuale që është, floktarët kanë vendosur ashtu, mirëpo unë e mbështes që kjo ndalesë t'iu hiqet. Dy propozimet e kolegut z.Naim Çunaku ishin me vend. Ky dokument nuk mund të ndryshohet deri nesër në Kuvend dhe sjellët kështu siç është tani, mirëpo propozimet mundemi ne ti bëjmë në seancë dhe gjatë seancës së Kuvendit mund të ndryshohet rregullorja, kështu që unë i mbështes dhe jamë që të vendoset ashtu si ishin dy propozimet e kolegut z.Naim Çunaku e që mendoj se të dyjat ishin me vend.

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, theksoi, falënderoj dy anëtarët e Kuvendit për kontributin e dhënë, mirëpo tani vetëm dëshiroj të sqarohemi se drafti i Rregullores a të sjellët nesër në Kuvend me ndryshime apo po e lëmë që nesër të bëhen këto propozime dhe mandej të mbështeten ato, andaj ashtu siç e vlerësoni ju edhe veprojmë sepse edhe unë mendoj se kjo është e duhura.

z.Naim Çunaku, theksoi, i nderuar drejtor, kjo që e potencova dhe që po e potencoj të merret si bashkëbisedim më shumë. Këtë që e potencove nuk mund ta ndryshosh sot sepse njëherë e ke sjellë një draft dhe çdo gjë që ndryshohet duhet të ketë propozim konkret në mënyrë që të mund të ndryshohet diçka nga drafti i sjellë, e që edhe ti drejtor mundesh nesër ta bësh propozimin, por nuk mund ta ndryshosh, dua të them se me propozime mund të ndryshohet, nëse isha i kjartë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra po mbetet që nesër të dilet me propozime konkrete, madje do të ishte mirë të paraqiten edhe me shkrim në mënyrë që pastaj të njëjtat të hedhen në votim ato propozim ndryshime që po diskutohen të bëhen në Rregullore. Besoj se kjo do të ishte shumë në rregull, pastaj nëse i miraton Kuvendi natyrisht sepse nuk jemi vetëm ne ata që vendosim

znj.Adelinë Stublla, theksoi, të gjitha ndryshimet, idetë dhe sugjerimet tona si Grup i LVV-së do t'i dërgojmë dhe paraqesim nesër në seancën e Kuvendit, i diskutojmë dhe në fund i hedhim në votim dhe në fund miratohen besoj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, mendoj se kjo Rregullore është shumë me rëndësi sepse prek edhe qytetarët edhe bizneset, dhe këto të dyja të lidhura mes vete.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Grupi i asamblistëve të LVV-së e mbështet këtë pikë të rendit të ditës dhe i propozon Kuvendit për seancën e nesërme.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, atëherë e hedh në votim që kjo draft Rregullore të rekomandohet për diskutim në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të Komunës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim dhe shqyrtim të draft Rregullores për orarin e punës së bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës, sipas draftit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

5. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL 2023-2025

z.Vigan Salihu, U.D. drejtor i DPZHE, e paraqiti fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, ky është një dokument shumë i rëndësishëm për Komunën e Podujevës i cili mund të na jep një rrugëtim / udhëzim për vitet e ardhshme sa i përket zhvillimit ekonomik të Podujevës. Ky dokument është proceduar ashtu siç është praktikë në të gjitha Komunat, përmes Zyrës së prokurimit ku kompanitë e specializuara kanë punuar në drejtim të krijimit të këtij dokumenti e që mbështetje i ka dhënë edhe Grupi punues nga radhët e Ekzekutivit të Komunës në krye me Nënkryetaren e Komunës. Andaj propozoj që edhe kjo të hedhet në rend të ditës për mbledhjen e Kuvendit, për vënie në diskutim publik. **Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, urdhëroni nëse ndokush ka të lajmëruar për të marrë fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e ardhshme.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit për vënie në diskutim publik - Draft Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal - SZHEL 2023-2025, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

6. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit-DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, me materialin përkatës ne ju kemi dërguar edhe materialin e draftit të Planit të mobilitetit të qëndrueshëm urban, plan i cili tanë së voni është futur në sferën e pushtetit lokal ku disa Komuna kanë filluar të punojnë rreth këtij plani, por edhe ne si Komunë e Podujevës kemi punuar në këtë drejtim dhe e kemi përgatitur këtë draft për të cilin fillimisht kërkojmë që të ketë miratim nga ana e Kuvendit për vënie në diskutim publik.

Gjatë kohës së diskutimit publik besoj se bashkërisht do të punojmë në mënyrë që në fund të jetë një plan sa më i mirë dhe sa më i pranueshëm dhe një plan i cili ashtu siç e ka për qëllim rregullimin e lëvizshmërisë së lirë në Qytetin e Podujevës, ta ketë edhe mbështetjen e juaj, por gjithsesi duke i marrë parasysh edhe propozimet e juaja dhe duke i vë në këtë plan i cili është përgatitur kohë më parë, jo larg, e që tani ne e kemi marrë dhe e kemi punuar ende në të, sepse lëvizshmëria e lirë apo siguria e lirë në trafik nuk është se nuk ka pësuar ndryshime prej se është bërë përgatitja e këtij draft plani, prandaj kështu siç edhe ju është dërguar si material kërkojmë të vëhet në diskutim publik dhe që gjatë kohëzgjatjes së diskutimit mirëpresim propozimet dhe sugjerimet e juaja në mënyrë që plani të jetë sa i pranueshëm për ne dhe për qytetarët.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Grupi i asambleistëve të LVV-së e mbështet këtë pikë të rendit të ditës dhe të njëjtën e rekomandon për seancën e nesërme të Kuvendit

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim vendimit për vënie në diskutim publik - Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

7. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Bonuset e Zonimit

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë për këtë pikë të rendit të ditës nuk e kemi prezent drejtorinë drejtorisë përkatëse që edhe e ka propozuar këtë propozim vendim, andaj meqë askush nuk po e kërkon fjalën më mbetet që vetëm ta hedh në votim kështu siç është, që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e nesërme.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim Vendimit për vënie në diskutim publik-Draft Rregullorja për Bonuset e Zonimit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

8. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me një Rregullore për taksitë e cila rregullon transportin e personave me automjete taksi, dokumenti i cili i ka munguar Komunës tonë edhe pse deri metani rregullimi është bërë në bazë të rregullores për transport, mirëpo tani me Ligjin e ri përkatës ka dalë që të nxjerrën edhe rregullore të tilla, andaj fillimisht e kemi sjellë të marrim mbështetje për ta vë në diskutim publik, andaj pres mbështetjen nga ana juaj edhe pse më shumë do të kenë punë pothuajse taksistët ngase edhe ata vetë e kanë kërkuar një gjë të tillë e që shpresoj se bashkërisht me ata por edhe me shoqata të transporteve të ndryshme që operojnë brenda Komunës së Podujevës, do të punojmë gjatë fazës së diskutimit publik në mënyrë që në fund ta kemi të miratuar një rregullore e cila do të rregulloj këtë çështje në mënyrën qysh edhe ata e kërkojnë sepse faktikisht për ata është por edhe Komunës i konvenon sa i përket taksave dhe tatimeve.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e radhës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim Vendimit për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin e udhëtarëve me automjete taksi, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

9. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, edhe kjo draft Rregullore ndërlihet dha ka lidhshmëri me atë paraprake dhe atë në vijim për sa i përket transportit e që pothuajse të gjitha burojnë nga plani i mobilitetit apo që ndërlihen me këtë plan, prandaj edhe ka qenë qëllimi që t'i procedojmë të gjitha në këtë seancë për t'i vë në diskutim publik këto dokumente.

Materiali përkatës ju është dërguar me kohë dhe besoj se në seancën e nesërme do t'i diskutojmë të gjitha për këtë çështje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë edhe për pikë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e radhës

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim Vendimit për vënie në diskutim publik - Draft Rregullorja për Transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

10. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë dokument besoj se është mjaft me rëndësi sepse jemi dëshmitar se në këtë aspekt ka probleme mes atyre që merren me transportin publik, andaj për më shumë fjalën ja jap sërish drejtorit të drejtorisë përkatëse.

z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, e potencova edhe më parë se të gjitha këto rregullore dhe dokumente e bëjnë rregullimin e transportit dhe qarkullimit të lirë në territorin e Komunës së Podujevës kanë një ndërlidhshmëri ndër vete, e që edhe ky Vendim është pasues nga Rregullorja për transportin rrugor në territorin e Komunës së Podujevës.

E vërtetë është ajo që e potencoj Kryesuesi i Kuvendit që me linjat urbane dhe ato urbano-periferike kemi pasë probleme nëse mund ta quaj kështu dhe janë adresuar shumë kërkesa dhe ankesa në Drejtori, prandaj kemi përgatitur një propozim vendim me të cilin synojmë t'i rregullojmë transportuesit që përfshihen në linjat urbane dhe ato urbano-periferike, e që kontributi i tyre do të jetë primar dhe kryesor në fazën e diskutimit publik me qëllim që të evitohen disa konflikte të interesit që ekzistojnë mes kompanive që operojnë me transport brenda Komunës tonë.

Pra caktohen linjat me kohë dhe orare të caktuara, prandaj e kemi proceduar për diskutim publik në mënyrë që të marrim edhe mendimet e Kuvendit, qytetarëve dhe atë atyre që kanë paraqitur kërkesa dhe ankesa të ndryshme sa i përket kësaj çështje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, shumica prej neve jemi në dijeni se kompanitë përkatëse që operojnë në Komunën e Podujevës shpeshherë kanë probleme sa i përket orarit dhe linjave, andaj mendoj se ky rregullim do ta përmirësoj gjendjen, prandaj meqë edhe për pikë të rendit të ditës nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në seancën e radhës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të propozim Vendimit për vënie në diskutim publik - Propozim Vendimi për caktimin e rrjetit të linjave urbane, urbano-periferike dhe orarin e qarkullimit, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje, dhe që kohëzgjatja, datat dhe vendi i mbajtjes së konsultimeve publike të propozohen dhe caktohen në mbledhjen e Kuvendit.

11. Informatë për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB për vitin 2021

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kjo informatë është sjellë nga Kryetari i Komunës i cili sipas detyrës zyrtare është edhe Kryetar i KKSB-së, andaj kush është që t'i rekomandohet kuvendit për diskutim si informatë.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim.

12. Propozim Plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB, për vitin 2022 - Kalendari i aktiviteteve të rregullta

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe ky dokument ka të bëjë me KKSB-në dhe si i tillë po ashtu është sjellë nga kryetari i Komunës, andaj nëse nuk keni diçka mund ta rekomandojmë për seancën e nesërme të Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se njëzëri me 9 vota Për, nga anëtarët e KPF-së, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim Propozim plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi - KKSB për vitin 2022, sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje

13. Matja e performancës së Komunës për vitin 2020

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, këtë pikë të rendit të ditës e ka sjellë Nënkryetarja e Komunës znj.Marigonë Lahu e cila nuk është prezent sot këtu, andaj nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë mund t'i rekomandojmë Kuvendit këtë pikët të rendit të ditës edhe pse pas dy viteve sepse ky dokument është i vitit 2020.

z.Naim Çunaku, theksoi, mua po më pengon, por fundja nëse nuk ju pengon edhe juve atëherë vazhdojmë, fjala është për këtë qasje dhe këtë formë e që mendoj se jemi duke e degraduar në rend të parë vetveten por edhe institucionin. Të propozohet diçka dhe të mos jenë prezent zyrtarët përkatëse për ta arsyetuar dhe të shkoqësin problemet, kjo është shumë serioze. Definitivisht po më dhimbset një qytetar që ka dhënë shpresën, besimin de të gjitha se do të bëjmë diçka. Aspak nuk e kam në aspektin partiak këtë që po e them, por vërtetë është jo serioze që të propozosh diçka e të mos jetë drejtori prezent, a jemi ardh këtu për të bërë shaka ose a jemi ardh këtu për tu kompensuar 50€, vërtetë shqetësuese.

znj.Adelinë Stublla, theksoi, pajtohem plotësisht me mendimin e kolegut parafolës për atë që e potencoj, kjo për shkak se kushdo që të jetë prej drejtorëve apo Nënkryetarja në këtë rast, duhet të jetë prezent për shkak se ne jemi anëtar të Kuvendit të zgjedhur të popullit, kështu që gjithçka duhet të jetë në koordinim me ata, dhe ata normal se duhet të na përgjigjen neve për çdo gjë që kemi.

Kështu që kjo paska tregon një jo seriozitet sa i përket edhe punës së drejtorit por edhe punës së Nënkryetares.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë pajtohem me ju dhe mendoj se është shqetësuese kjo që të sjellën materialet dhe të mos jenë prezent këtu për të prezantuar atë, është shumë keq. Madje ne mund të vendosim qysh tani që herave tjera që ai që e sjellë një pikë dhe nuk është prezent, ajo pikë të mos i rekomandohet Kuvendit fare, unë jam për këtë dhe çdo herë do ta votoj kundër çdo herë.

Pra kjo të jetë hera e fundit që rekomandojmë diçka pa qenë prezent përfaqësuesi nga Ekzekutivi.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, pajtohem me Kryesuesin dhe ne nga sot mund të vendosim që herave tjera asnjë pikë të mos i rekomandohet Kuvendit nëse nuk është prezent drejtori apo ai që ka sjellë pikën, përveç nëse ka ndonjë rast të arsyeshëm.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë jam që nëse një drejtor që ka sjellë pikën përkatëse nuk është prezent në mbledhjen e KPF-së, të mos i kaloj ajo pikë. Madje ne jemi në dijeni se në të gjitha Drejtoritë ka edhe shefa të sektorëve i cili mund të vije si zëvendësues i drejtorit, siç është në këtë rast për Drejtorinë e Urbanizmit, vërtetë është për keqardhje dhe ju falënderoj për diskutim sepse ishit shumë konkret.

E hedh në votim që edhe kjo pikë e rendit të ditës të rekomandohet për Kuvend, për herë të fundit pa qenë prezent ndokush për ta prezantuar si pikë.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtar të KPF-së, me 5 vota Për, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të dokumentit – Matja e performancës së komunës për vitin 2020 .

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe njëherë, kjo që po e them të merret krejt miqësisht, ku dikush nuk votohet as Për, as Kundër, as kur nuk Abstenon, nuk është pjesë e votimit, dhe në këtë rast nëse votojnë 5 normal që kalojnë, andaj në rastin konkret për çka diskutuam në një formë nëse ata (drejtorët dhe të tjerët) abstenojnë sa i përket mbledhjes së KPF-së, atëherë edhe ne nuk votojmë fare, apo në një formë edhe ne abstenojmë nga votimi. Pra në këtë rast nuk jemi pjesë e vendimmarrjes.

14. Ndryshimi i përbërjes së Komisionit Komunal të aksionarëve të ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë (pas ofrimit të dorëheqjes nga njëri prej anëtarëve të Komisionit nga radhët e Kuvendit të Komunës - bashkëngjitur në material)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, bëhet fjalë për një dorëheqje të një prej anëtarëve të Komisionit përkatës të cilën keni mund ta shihni edhe në materialin e dërguar, pra z.Fitim Muçolli ka dhënë dorëheqje i cili ka qenë anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike - Stacioni i Autobusëve Podujevë, nga radhët e LVV-së e që sot duhet të zëvendësohet me një anëtar/e, kështu që nëse sot keni propozim mund ta diskutojmë dhe t'i rekomandojmë Kuvendit këtë pikë të rendit të ditës duke përfshirë edhe emrin e propozuar.

znj. Adelinë Stublla, theksoi, ne Grupi nga radhët e LVV-së në vend të z.Fitim Muçolli ish anëtar në këtë Komision, e propozojmë z.Kasib Bashotën.

Kryesues i Komitetit, theksoi, pra kemi propozim konkret për caktimin e anëtarit nga radhët e Kuvendit në Komisionin Komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës përfshirë edhe propozimin e znj. Adelinë Stublla.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 9 anëtar të KPF-së, me 5 vota Për, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës, përkatësisht anëtari i Kuvendit z.Kasib Bashota të caktohet në përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të NP Stacioni i Autobusëve Podujevë, pas ofrimit të dorëheqjes nga anëtari z.Fitim Muçolli.

Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0083627/22
Podujevë,
28 shtator 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**